

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT TIRANE

14712/1

V E N D I M
I
GJYQTARIT TE VETEM

Une, gjyqtare e Gjykatës së Rrethit Tirane M. Deqi,
sot me date 19-12-16, mora në shqyrtim kërkesën e
paraqitur nga Drejtore e Drejtorisë së Shoqërive Publike,
Znj. Pranvera Zeneli, lidhur me depozitimin e urdherit të
Ministrit të Privatizimeve, Z. Dylber Vrioni.

K O N S T A T O V A

Se me vendimin Nr. 14212 date 14.3.1996 të Gjykatës së
Rrethit Tirane, shoqëria anonime "BOJE LLAQE" TIRANE, është
rregjistruar si person juridik me kapital themeltar 75.563.000
leke.

Me urdherin Nr. 134/2, date 17-12-..... 1996 të Ministrit të
Privatizimeve është vendosur zvoglimi i kapitalit themeltar të
shoqërisë "BOJE LLAQE" Tirane Sh.A. për 6.119.000 dhe kapitali
themeltar mbetet 69.444.000 leke, nga e cila vlera e truallit
gjithsej 15.907.200 leke.

Nga shqyrtimi i akteve të depozituara rezultoi se kërkesa
e paraqitur është e bazuar dhe dokumentacioni i paraqitur me këtë
rast është i plotë.

Per kete arsye

Ne baze të nenit 24 të ligjit 7667 date 28.01.1993 dhe
ligjit 7638 date 19.11.1992.

Vendosa

Depozitimin në zyrën e rregjistrimit tregtar të urdherit
Nr. 134/2, date 17-12-16, të Ministrit të Privatizimeve
lidhur me zvoglimin e kapitalit themeltar të Sh.A. "BOJE LLAQE"
TIRANE, duke u bërë shenimi përkatës në fletën e rregjistrimit në
kollonën Nr. 4 dhe 5, nr. rendor 2. Të ndahen rregjistrimet me vije
nga njeri tjetri. Të publikohet vendimi i mesiperm.

GJYQTARE
Majomir Deqi
M. Deqi

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT TIRANE
Nr 1421/2000 Akt

VENDIM
I Gjyqtarit te Vetem

Une gjyqtare e Gjykates se Rrethit Tirane Mariana Dedi sot me date 11/05/2000, mora ne shqyrtim kerkesen e paraqitur nga drejtori i shoqerise anonime "Bojra Llake"sha, Koco Kokedhima dhe

KONSTATOVA

Se me kerkesen drejtuar Gjykates, drejtori i shoqerise Koco Kokedhima kerkon depozitim e vendimeve te Mbledhjes se Jashtezakonshme te Aksionereve.

Sipas dokumentacionit te paraqitur rezulton se:

Me vendimin nr.1 date 27/4/2000 mbledhja e jashtezakonshme e shoqerise ka vendosur te zmadhoje kapitalin e saj themeltar, ne natyre. Sipas raportit te vleresimit te ekspertit kontabel kapitali themeltar i shoqerise pas zmadhimit behet 121,392,918. Leke.

Pas zmadhimit te kapitalit ndryshon raporti i zoterimit te asioneve ku z. Koco Kokedhima zoteron 90,921% te aksioneve ose 110,371.655 aksione dhe Ministria e Ekonomise Publike dhe Privatizimit zoteron 9,079% te aksione ose 11,021.261 aksione gjithsej

Me vendimin nr.3 Mbledhja e Jashtezakonshme e shoqerise ka vendosur Ndryshimin e emrit te shoqerise me emrin e ri "Boja Tirana"sha.

Ne keto kushte mbeshtetur ne ligjin nr. 7638 date 19.11. 1992 "Per shoqerite Tregtare" te ligjit nr. 7667 dt. 28.01.1993 dhe ligjit nr. 7926 date 20.04.1995, cmoj se kerkesa e paraqitur eshte e bazuar ne ligj dhe si e tille duhet te pranohet.

PER KETO ARSYE

Ne baze te ligjit nr. 7667 dt. 28.01.1993 dhe ligjit nr. 7938 date 19.11.1992 ;

VENDOSA

Depozitim e vendimeve nr. 2 dhe nr.3 te Asmablse se Jashtezakonshme te aksionereve.

- Kapitali themeltar i shoqerise pas zmadhimit eshte 121,392,918. Leke .
- Aksioneri Koco Kokedhima zoteron 90,921% te aksioneve gjithsej ose 110,371.655 aksione
- Ministria e Ekonomise Publike dhe Privatizimit zoteron 9.079% te aksione gjithsej ose 11,021.261 aksione.

Depozitim e vendimit nr.2 te Asamblese se Jashtezakonshme te aksionereve.


- Emri i ri i shoqerise eshte "Boja Tirana"sha.

Ndarjen e vendime me vize nga njeri tjetri.

Kunder Vendimit mund te behet ankim brenda 15 diteve ne Gjykatën e Apelit

Tirane date 12/02/2000.

GJYQTARE
Mariana Dedi



25
16.01.2015

ASAMBLEJA E AKSIONARËVE
“BOJA TIRANA” SH.A.

VENDIM NR.4
DATË 27.11.2014
I ASAMBLESË SË AKSIONARËVE TË SHOQËRISË
“BOJA TIRANA” SH.A.

Sot, më datë 27.11.2014, ora 11:00 në adresën Rruga: “Ismail Qemali”, Pallati “Abissnet”, Kati i II, sipas njoftimit drejtuar aksionarit Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes me shkresën nr. 611/1 Prot., datë 06.11.2014 protokolluar pranë kësaj Ministrie me nr. 7684/1 Prot., datë 06.11.2014 mbahet mbledhja e Asamblesë së Aksionarëve të shoqërisë “Boja Tirana” sh.a.

Në këtë mbledhje është i pranishëm vetëm aksionari Koço Kokëdhima, zotërues i 90.92% të kapitalit të shoqërisë;

Konstatohet se aksionari “Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes”, zotëruese e 9.08 % të kapitalit të shoqërisë, ka marrë rregullisht dijeni për mbajtjen e mbledhjes sipas njoftimit nr. 611/1 Prot., datë 06.11.2014 protokolluar pranë kësaj Ministrie me nr. 7684/1 Prot., datë 06.11.2014.

Mbledhja zhvillohet duke respektuar kuorumin e përfaqësimit, pasi është i pranishëm aksionari që përfaqëson më shumë se gjysmën e kapitalit të shoqërisë.

Në bazë të nenit 144 dhe 145 te ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregëtarit dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, mbledhja konsiderohet e rregullt.

Në përputhje me njoftimin, rendi i ditës është:

- 1- Miratimi i Raportit të Zmadhimit të Kapitalit të shoqërisë “Boja Tirana” sh.a., për gatitur nga shoqëria audituese “Jaupaj-G” sh.p.k.;
- 2- Të ndryshme.

Për sa më sipër, aksionari i pranishëm,



VENDOSI:

1. Të miratojë Raportin e Zmadhimit të Kapitalit të shoqërisë “Boja Tirana” sh.a., përgatitur nga shoqëria audituese “Jaupaj-G” sh.p.k.

Sipas Raportit të Zmadhimit të Kapitalit, fitimi i realizuar gjatë vitit 2013 në shumën prej 2,162,514 (dy milionë e njëqindë e gjashtëdhjetë e dymijë e pesëqindë e katërbëdhjetë) Lekë destinohet në këtë menyrë:

- 162,514 (njëqindë e gjashtëdhjetë e dy mijë e pesëqindë e katërbëdhjetë) Lekë destinohet për rezervën ligjore;
- Shuma prej 2,000,000 (dy milionë) Lekë destinohet për zmadhim kapitali të shoqërisë. Pas këtij zmadhimi, kapitali i shoqërisë “Boja Tirana” sh.a. bëhet 123,392,918 (njëqindë e njëzetë e tremilionë e treqindë e nëntëdhjetë e dymijë e nëntëqindë e tetëmbëdhjetë) Lekë i ndarë në 123,392 (njëqindë e njëzetë e tremijë e treqindë e nëntëdhjetë e dy) aksione me vlerë nominale 1.000,01 Lekë secila, të zotëruara nga aksionarët sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Aksionari	Numri aksioneve	% e pjesëmarrjes	Kontributi në Lekë
1.	Koço Kokëdhima	112,189.42	90.92	112,190,258
2.	Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes	11,202.58	9.08	11,202,660
	Shuma	123,392.00	100.00	123,392,918

AKSIONARI I PRANISHËM

KOÇO KOKËDHIMA



SHOQËRIA "BOJA TIRANA" SH.A.
NIPT: J61817074A
ADRESA E SELISË: RRUGA "5 MAJI",
TIRANË

Tiranë, më 29/12/2015

DEKLARATË

Sot, më datë 29/12/2015, unë, Brixhilda Kokëdhima, në cilësinë e Administratores së shoqërisë "Boja Tirana" sha deklaroj se: *"Për efekt të zmadhimit të kapitalit me fondet e veta të shoqërisë sipas Vendimit nr.4, datë 27.11.2014 të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve të shoqërisë "Boja Tirana" sha, deklaroj se gjendja e aktiveve të shoqërisë është e tillë që sikur të merret një vendim për zmadhimin e kapitalit themeltar në datën e bërjes së kërkesës për regjistrim në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, zmadhimi do të ishte ende i mundur".*

PËR SHOQËRINË "BOJA TIRANA" SHA
ADMINISTRATORE
BRIXHILDA KOKËDHIMA

Brixhilda Kokëdhima



25
16

7684/1
6/11/2014

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHOQËRIA "BOJA TIRANA" SH.A.
NIPT: J61817074A



Nr. 611/I Prot
dt 06.11.2014

NJOFTIM
PËR MBLEDHJEN E ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME TË AKSIONARËVE
TË SHOQËRISË "BOJA TIRANA" SH.A.

Drejtuar: Aksionarëve të Shoqërisë "BOJA TIRANA" SH.A.
Aksionarit Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe
Sipërmarrjes

Lënda: Mbledhje e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve

Në cilësinë e Administratores së shoqërisë "Boja Tirana" sh.a, Ju njoftoj se në date 27.11.2014 ora 11:00 në adresën Rruga: Ismail Qemali, Pallati "Abissnet", Kati i II, do të mbahet mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve të shoqërisë për të diskutuar çështjet e përfshira në rend dite si më poshtë vijon:

- 1- Miratimi i Raportit të Zmadhimit të Kapitalit të shoqërisë "Boja Tirana" sh.a., përgatitur nga shoqëria audituese "Jaupaj-G" sh.p.k.;
- 2- Të ndryshme.

-Çdo aksionar ka të drejtë të parashtrojë sugjerime në lidhje me çështjet e rendit të ditës, të përmendura më sipër apo të përfshijë çështje të tjera të caktuara në rend dite, të cilat duhet t'i drejtohen Administratorit të shoqërisë jo më vonë se 8 (tetë) ditë përpara datës së mbledhjes së Asamblesë;

-Në lidhje me pjesëmarrjen në mbledhjen e Asamblesë, çdo aksionar ka të drejtë të përfaqësohet në mbledhje nga një aksionar tjetër ose person i tretë në bazë të një autorizimi.

PËR SHOQËRINË "BOJA TIRANA" SH.A.
ADMINISTARTORE

BRIXHILDA KOKËDHIMA

Brixhilda Kokëdhima

25
16.01.2015

“Boja Tirana sh.a.”

Tirane

N.i.u.s. J61817074A

RAPORT

I EKSPERTIT PER VLERESIMIN E REZERVAVE DHE
FITIMEVE TE PA SHPERNDARA PER ZMADHIMIN E
KAPITALIT AKSIONER TE SHOQERISE
SIPAS GJENDJES SE BILANCIT NE 31.12.2013

Tirane, me *25 Nëntor* 2014

RAPORT

I EKSPERTIT KONTABEL TE AUTORIZUAR PER ZMADHIMIN E KAPITALIT AKSIONER TE SHOQERISE

“Boja Tirana sh.a.” Tirane

Une i autorizuari Gezim Jaupaj, me license profesionale Nr.112, date 21.12.2000, ne emer te shoqerise audituese “Jaupaj_G” sh.p.k, jam caktuar me vendimin, date 24.11.2014, te Asamblese se Aksionereve te Shoqerise Anonime “Boja Tirana”sh.a. Tirane , per **vleresimin e rezervave dhe fitimeve te pashperndara**, per realizimin e **zmadhimit te kapitalit aksioner te shoqerise**.

Per te kryer misionin e ngarkuar, jam mbeshtetur :

Ne kete baze ligjore,

- Ligji 9901 date 14.04.2008 ,me ndryshime “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare” ,
- Ligji 9228 date 29.04.2004 “Per kontabilitetin dhe pasqyrat financiare ”
- Vendimi date 24.11.2014 i Asamblese se Aksionereve te shoqerise,
- Statutit dhe akti i themelimit te shoqerise “Boja Tirana” sh.a.

Ne kete dokumentacion,


- Bilanci i shoqerise, mbyllur me 31 Dhjetor 2013

I caktuar me cilesine e ekspertit per vleresimin e rezervave dhe fitimeve, gjendje me 31.12.2013

Raportoj sa me poshte vijon :

Kam verifikuar bilancin e shoqerise te mbyllur me 31 Dhjetor 2013, para zmadhimit te kapitalit qe paraqitet si vijon,

A K T I V I	Vlera ne leke	P A S I V I	Vlera ne leke
1.Aktivet monetare	196,019	1.Detyrime te pagueshme	6,930,209
2.Kerkesa te arketueshme	70,112,056	2.Detyrime afatgjata	0
3.Inventariale	10,122,138	3.Te ardhura avance	979,200
4. Parapagime	0	4.Kapitali aksioner	121,392,918
5.A.A.M. (vlere e mbetur)	23,765,985	5.Rezerva ligjore	0
		6.Humbje e mbartur	(27,268,643)

 2

		7.Fitimi vitit 2013	2,162,514
TOTALI I AKTIVIT	104,196,198	TOTALI I PASIVIT	104,196,198

Kapitali i nenshkruar,rezervat dhe fitimi, gjendje me 31.12.2013 per shumen 96,286,789leke, nga zbatimi i procedurave audit konform SNA rezulton se ekzistojne dhe kane kundraparti reale ne aktivin e bilancit te shoqerise si : - Mjete monetare ne arke , banke,instalime teknike, makineri,paisje e vegla pune, mjete transporti, paisje zyre dhe informatike, produkte dhe mallra, kerkesa per tu arketuar per mallra dhe sherbime te kryera dhe kerkesa te tjera, qe plotesojne kerkesat ligjore per zmadhimin e ketij kapitali.

Opinionimi im eshte se plotesohen dhe jane reale mundesite per disponimin e fitimit te realizuar gjate vitit 2013.

- Shtim i kapitalit aksioner 2 000 000 leke.
- Shtim i rezervave ligjore ne shumen 162 514 leke.

Kemi verifikuar procedurat lidhur me percaktimin e kapitalit aksioner dhe rezervat ligjore te shoqerise qe do krijohet nga procesi i zmadhimit me fitimet e realizuara. Nga verifikimet e kryera konstatojme se jane respektuar regullat e parashikuara ne ligjin "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare".

Regjistrimet kontabel te veprimeve lidhur me percaktimin e kapitalit aksioner dhe rezervave te shoqerise, jane kryer ne menyre te plote e te regullt ne perputhje me kerkesat e ligjit "Per kontabilitetin".

Bilanci i shoqerise pas rritjes se kapitalit, paraqitet ne kete menyre :

A K T I V I	Vlera ne leke	P A S I V I	Vlera ne leke
1.Aktivet monetare	196,019	1.Detyrime te pagueshme	6,930,209
2.Kerkesa te arketueshme	70,112,056	2.Detyrime afatgjata	0
3.Inventariale	10,122,138	3.Te ardhura avance	979,200
4. Parapagime	0	4.Kapitali aksioner	123,392,918
5.A.A.M. (vlere e mbetur)	23,765,985	5.Rezerva ligjore	162,514
		6.Humbje e mbartur	(27,268,643)
		7.Fitimi vitit 2013	0
TOTALI I AKTIVIT	104,196,198	TOTALI I PASIVIT	104,196,198

Bilanci i celjes, qe krijohet pas zmadhimit te kapitalit per sa me larte, jep nje pamje te sinqerte e te vertete te pasurise se shoqerise "Boja Tirana"sh.a.

[Signature]

Kapitali aksioner behet 123 392 918 leke i ndare ne 123 392 aksione, vlera nominale e nje aksioni mbetet 1 000,01 leke. Numri i aksioneve,perqindja ne kapital,dhe kontributi ne para i ndare sipas aksionereve behet:

nr	Ortaku	ISHTE				BEHET		
		Numri aksioneve	% pjesmarrjes	Vlera nom. e nje aksioni	Kontrib.lek	Numri aksioneve	% pjesmarrjes	Kontrib
1	Koço Kokedhima	110,371.00	90.92	1,000.01	110,371,835	112,189.42	90.92	112,190
2	Ministria e Ek. Treg. Energj.	11,021.00	9.08	1,000.01	11,021,083	11,202.58	9.08	11,202
	Shuma	121,392.00	100.00		121,392,918	123,392.00	100.00	123,392

- Koço Kokedhima 112 189,42 aksione, perqindja ne kapital 90,92 %, kontributi ne leke 112 190 258.
- Ministria e Ekonomise, Tregetise dhe Energjetikes 11 202,58 aksione, perqindja ne kapital 9,08 %, kontributi ne leke 11 202 660.
- Rezervat ligjore behen 162 514 leke.

Vlera totale e kapitalit i pergjigjet vleres reale te aktiveve te shoqerise te materializuara ne :- Instalime teknike, makineri,paisje e vegla pune, mjete transporti, paisje zyre dhe informatike, produkte dhe mallra, kerkesa per tu arketuar per mallra dhe sherbime te kryera dhe te tjera, qe jane te pasqyruara ne aktivin e bilancit te mbyllur me 31 Dhjetor 2013.

Opinionimi im eshte se shtesa e kapitalit eshte e rregullt, duke pare edhe vertetesine dhe sinqeritetin e llogarive te bilancit 31.12.2013.

Shoqeria audituese "Jaupaj-G"sh.p.k

Perfaqesues ligjor

Eksperti Kontabel i Autorizuar

Gezim Jaupaj



SHOQËRIA “BOJA TIRANA” SHA
NUIS: J61817074A
ADRESA E SELISË: RRUGA “5 MAJI”,
TIRANË

VENDIM NR.3
DATË 27/12/2019
I ASAMBLESE SË PËRGJITHSHME TË AKSIONARËVE
TË SHOQËRISË “BOJA TIRANA”SHA

Sot, më datë 27.12.2019, ora 12:00, në adresën: Rruga “Ismail Qemali”, Pallati 18, Kati II-të, Tiranë, sipas njoftimit nr. 14 Prot., datë 05.12.2019, drejtuar aksionarit “Ministria e Financave dhe Ekonomisë”, protokolluar pranë kësaj Ministrie me nr. 22213 Prot., datë 05.12.2019, u mbajt mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve të shoqërisë “Boja Tirana”sha.

Në këtë mbledhje është i pranishëm vetëm njëri prej aksionarëve të shoqërisë, dhe konkretisht:

1. Koço Kokëdhima, i cili zotëron 90,92% të kapitalit të shoqërisë “Boja Tirana”sha.

Konstatohet se aksionari “Ministria e Financave dhe Ekonomisë”, zotërues i 9,08 % të kapitalit të shoqërisë, ka marrë rregullisht dijëni për mbajtjen e mbledhjes sipas njoftimit nr. 14 Prot., datë 05.12.2019, protokolluar pranë kësaj Ministrie me nr. 22213 Prot., datë 05.12.2019.

Mbledhja zhvillohet duke respektuar kuorumin e përfaqësimit, pasi është i pranishëm aksionari që përfaqëson më shumë se gjysmën e kapitalit të shoqërisë “Boja Tirana”sha.

Në bazë të nenit 144 dhe 145 të ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar, mbledhja konsiderohet e rregullt.

Në përputhje me njoftimin, rendi i ditës është si më poshtë:

1. Miratimi i ekspertit kontabël të autorizuar, Bujar Rami, me Licencë nr.90, datë 07.12.2000;
2. Miratimi i Raportit të Zmadhimit të Kapitalit të shoqërisë “Boja Tirana”sha, përgatitur nga eksperti kontabël i autorizuar, Bujar Rami;
3. Të ndryshme sipas propozimeve.

Aksionari i pranishëm, pasi shqyrtoi çështjet e përfshira në rendin e ditës,

VENDOSI:

1. Miratimin e ekspertit kontabël të autorizuar, Bujar Rami, me Licencë nr.90, datë 07.12.2000;
2. Miratimin e Raportit të Zmadhimit të Kapitalit të shoqërisë “Boja Tirana”sha, përgatitur nga eksperti kontabël i autorizuar, Bujar Rami;



Referuar bilancit vjetor të shoqërisë “Boja Tirana”sha, për vitin 2018, shoqëria ka rezultuar me fitim në shumën prej 6,126,160 (gjashtë milion e njëqind e njëzet e gjashtë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë) Lekë. Ky fitim është destinuar në këtë mënyrë:

- Shuma prej 311,097 (treqind e njëmbëdhjetë mijë e nëntëdhjetë e shtatë) Lekë, të destinohet për rezervë ligjore;
- Shuma 15,063 (pesëmbëdhjetë mijë e gjashtëdhjetë e tre) Lekë, të destinohet për pakësimin e humbjes së mbartur.
- Shuma 5,800,000 (pesë milion e tetëqind mijë) Lekë të destinohet për zmadhim kapitali.

Bilanci i shoqërisë pas rritjes së kapitalit, paraqitet në këtë mënyrë:

A K T I V I	Vlera ne leke	P A S I V I	Vlera ne leke
1.Aktivitet monetare	41,880	1.Detyrime te pagueshme	8,389,730
2.Kerkesa te arketueshme	92,504,178	2.Detyrime afatgjata	587,604
3.Inventariale	10,122,138	3.Te ardhura avance	0
4. Parapagime	0	4.Kapitali aksioner	129,192,918
5.A.A.M. (vlere e mbetur)	13,567,478	5.Rezerva ligjore	800,000
		6.Humbje e mbartur	(22,734,578)
		7.Fitimi vitit 2018	0
TOTALI I AKTIVIT	116,235,674	TOTALI I PASIVIT	116,235,674

Pas këtij zmadhimi, kapitali i shoqërisë “Boja Tirana”sha bëhet 129,192,918 (njëqind e njëzetë e nëntë milion e njëqind e nëntëdhjetë e dy mijë e nëntëqind e tetëmbëdhjetë) Lekë, i ndarë në 129,192 (njëqind e njëzetë e nëntë mijë e njëqind e nëntëdhjetë e dy) aksione me vlerë nominale 1,000.007 (një mijë pikë zero zero shtatë) Lekë secili; rezervat ligjore bëhen 800,000 (tetëqind mijë) Lekë.

Pas zmadhimit të kapitalit, zotërimi i tij nga aksionarët e shoqërisë ndryshon si më poshtë:

nr	Aksionarët	ISHTE			BEHET		
		Numri aksioneve	% pjesm arrjes	Kontrib.le k	Numri aksioneve	% pjesm arrjes	Kontrib.lek
1	Koço Kokedhima	112,189.42	90.92	112,190,258	117,461.37	90.92	117,462,201
2	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	11,202.58	9.08	11,202,660	11,730.63	9.08	11,730,717
	Shuma	123,392.00	100.00	123,392,918	129,192.00	100.00	129,192,918

Z. Koço Kokëdhima, zotëron 117,461.37 (njëqind e shtatëmbëdhjetë mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e një pikë tridhjetë e shtatë) aksione, me vlerë nominale 1,000.007 (një mijë pikë zero zero shtatë) Lekë secili, të cilat përbëjnë 90.92% (nëntëdhjetë pikë nëntëdhjetë e dy përqind) të kapitalit të shoqërisë, dhe me kontribut 117,462,201 (njëqind e shtatëmbëdhjetë milion e katërqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e dyqind e një) Lekë.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë, zotëron 11,730.63 (njëmbëdhjetë mijë e shtatëqind e tridhjetë pikë gjashtëdhjetë e tre) aksione, me vlerë nominale 1,000.007 (një mijë pikë zero zero shtatë) Lekë secili, të cilat përbëjnë 9.08% (nëntë pikë zero tetë përqind) të kapitalit të shoqërisë dhe me kontribut 11,730,717 (njëmbëdhjetë milion e shtatëqind e tridhjetë mijë e shtatëqind e shtatëmbëdhjetë) Lekë.

**ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E AKSIONARËVE
SHOQËRIA "BOJA TIRANA" SHA**

Z. Koço KOKËDHIMA



The image shows a handwritten signature in blue ink. The signature is stylized and appears to be 'Z. Koço Kokëdhima'. Overlaid on the signature is a circular blue stamp. The stamp contains the text 'SHOQËRIA "BOJA TIRANA" SHA' in the center, with 'SHËNIMET E TIRANËS' around the top edge and 'SHËNIMET E TIRANËS' around the bottom edge. The stamp is partially obscured by the signature.